



TARGET

Keep Antibiotics Working



Si të mblidhni një mostër urine në mes të urinimit (MSU)

Për fëmijët më të rritur, adoleshentët dhe të rriturit me sistem urinar mashkullor

Udhëzime të përgjithshme

Gjithmonë lani duart me ujë dhe sapun para dhe pas mbledhjes së mostrës së urinës.


Mos e hapni provëzën sterile derisa të jeni gati për të mbledhur mostrën.

Shmangni prekjen e pjesës së brendshme të provëzës dhe mos lejoni që organet tuaja gjenitale të prekin ndonjë pjesë të saj.

Nëse profesionisti i kujdesit shëndetësor jua ka kërkuar, vendosni etiketën në provëz përpara mbledhjes së mostrës.


Për të mbledhur një mostër urine në mes të urinimit

1



Hiqni kapakun e provëzës sterile dhe vendoseni mbi një sipërfaqe të pastër, me pjesën e brendshme të kthyer nga lart.

2



Tërhiqeni me kujdes lëkurën që mbulon kokën e penisit (lafshën), nëse e keni.

3



Filloni të urinoni në tualet (mos e mblidhni pjesën e parë të urinës). Pa e ndërprerë rrjedhën e urinës, vendosni provëzën në rrjedhë dhe mblidhni një sasi urine.

4



Mbusheni provëzën me sa më shumë urinë që të jetë e mundur, pa e tejmbushur, ose deri te vija e shënuar, nëse është e pranishme. Përfundoni urinimin në tualet.

5



Vendosjani sërish kapakun provëzës dhe shtrëngojeni mirë. Shpëlajeni dhe thajeni pjesën e jashtme të provëzës nëse është laqur.

6



Dorëzojeni mostrën e urinës tek ofruesi juaj i kujdesit shëndetësor sa më shpejt të jetë e mundur, së bashku me çdo formular ose etiketë që ju është kërkuar të plotësoni. Ndiqni këshillat në faqen 2.

Informacion përmbledhës

Çfarë është një mostër urine në mesin e rrjedhjes? Një mostër urine në mesin e rrjedhjes është një mostër urine e mbledhur në mes të procesit të urinimit.

Pse duhet ta mblidhni urinën në mesin e kryerjes së urinimit?

Urina e dalë në fillim të urinimit mund të marrë mikrobe nga lëkura, të cilat mund të ndikojnë në rezultatet e analizës. Mbledhja e mostrës në mes të urinimit ndihmon në shmangien e këtij kontaminimi dhe siguron rezultate më të sakta.

A duhet të laj zonën gjenitale para se të mbledh mostrën?

Nuk është e nevojshme të përdorni peceta të posaçme ose produkte pastrimi, përveç nëse profesionisti juaj i kujdesit shëndetësor ju udhëzon ndryshe. Sigurohuni që zona të jetë e pastër dhe e tharë.

A mund të përdor një kavanoz ose enë nga shtëpia?

Për mbledhjen e mostrës duhet të përdorni provëzën që ju ka dhënë profesionisti i kujdesit shëndetësor.

A ka rëndësi koha kur e mbledh mostrën?

Përpquni ta mblidhni mostrën sa më afër kohës së vizitës suaj, në mënyrë që të sigurohet cilësia më e mirë e mundshme e mostrës. Nëse është e mundur, përpquni ta mblidhni mostrën përpara se të filloni të merrni antibiotikë.

A ka raste kur kjo procedurë mund të ndryshojë?

Ndonjëherë, ofruesi juaj i kujdesit shëndetësor mund t'ju rekomandojë një metodë tjetër për mbledhjen e mostrës së urinës. Nëse ndodh kjo, ndiqni udhëzimet që ju jepen.

Këshilla për dorëzimin e mostrës së urinës

☒ **Dorëzoheni mostrën sa më shpejt**

Dorëzoheni te ofruesi juaj i kujdesit shëndetësor sa më shpejt të jetë e mundur, idealisht brenda dy orëve.

☒ **Verifikoni orarin e pranimit të mostrave**

Pyesni se deri në cilën orë pranohen mostrat, në mënyrë që mostra juaj të arrijë në laborator po atë ditë.

Mbajeni në temperaturë të ulët

Nëse nuk mund ta dorëzoni mostrën sa më shpejt që të mundeni, vendoseni në një qese plastike dhe ruajeni në frigorifer derisa të mund ta dorëzoni.

Përdorimi i provëzave speciale sterile

☒ Disa provëza përmbajnë një pluhur konservues dhe kanë një vijë orientuese që tregon nivelin e mbushjes. Përpquni ta mbushni provëzën deri tek vija e shënuar, por nëse nuk mundeni, mblidhni sa më shumë urinë që të mundeni.

Skani këtu për më shumë informacion

